

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ALBA CONFEZIONE” SHPK**

Sot, më datë 26/11/2018, ortaku si më poshtë:

1. **Shoqëria “G.P Industry” s.r.l** shoqëri tregtare e së drejtës italiane, regjistruar në Regjistrin Tregtar me Kodin Fiskal 02839830649, dhe seli në adresën: Contrada Montecalvo, 789 CAP 82100, Benevento (BN), Itali, përfaqësuar nga Administratori Z. Pasquale Cavoto, shtetas italian, lindur më 05.08.1960 në San Marco dei Cavoti (BN), Itali dhe banues në San Marco dei Cavoti (BN) në adresën: Via del Pozzo 93 CAP 82029, Itali, identifikuar me Pasaportën me Nr. AA3901652.

Vendosi të hartojë këtë Akt Themelimi, me përmbajtje si më poshtë:

**NENI 1**  
**DATA E THEMELIMIT**

Sot, më datë 26.11.2018, themeluesi Shoqëria “G.P Industry” s.r.l vendosi të krijojë një shoqëri me emërtimin “ALBA CONFEZIONE” SHPK.

**NENI 2**  
**FORMA E SHOQËRISË**

Kjo shoqëri do të jetë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

**NENI 3**  
**EMËRTIMI**


Emri i plotë i shoqërisë është “ALBA CONFEZIONE” SHPK.

**NENI 4**  
**SELIA**

Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresën: Rruga “Njazi Meka”, Kati 4, Godinë 5 KT, pranë Karburant Kastrati, Njesia Administrative Nr. 4. Me miratim të organeve të saj, shoqëria mund të ndryshojë selinë, mund të hapë degë, filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.

**NENI 5**  
**KOHËZGJATJA**

*Edmond G. Doreaj*





Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë, ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

#### NENI 6 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria “ALBA CONFEZIONE” SHPK do të ketë si objekt të veprimtarisë:

Aktivitet në fushën e përpunimit aktiv për artikuj të ndryshëm të veshjeve. Prodhimi dhe konfeksionimi i artikujve të veshjeve. Ushtrimi i veprimtarisë së fasonerisë në bashkëpunim me shoqëri vendase dhe të huaja.

Çdo aktivitet tjetër tregtar që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë dhe që është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### NENI 7 KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 10,000 (dhjetë mijë) Lekë, i zotëruar plotësisht nga ortaku si më poshtë:

Emri	Perqindja %	Kuota (pjesë)	Vlera e Pjesmarrjes
Shoqëria “G.P Industry” s.r.l	100 %	1	10,000 (lek)

Ky kapital është i ndarë në 1 (një) kuotë të zotëruar nga ortaku i vetëm.

Kapitali themeltar do të depozitohet në një Bankë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.



#### NENI 8 ADMINISTRATORI

Administratori i parë i shoqërisë “ALBA CONFEZIONE” SHPK do të jetë:

**Z. Pasquale Cavoto**, shtetas italian, lindur më 05.08.1960 në San Marco dei Cavoti (BN), Itali dhe banues në San Marco dei Cavoti (BN) në adresën: Via del Pozzo 93 CAP 82029, Itali, identifikuar me Pasaportën me Nr. AA3901652.

Kohëzgjatja e mandatit të tij është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

#### NENI 9



## DISPOZITAT E FUNDIT

Ky akt themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje, në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore.  
Të dhënat tregtare të detyrueshme si dhe të dhënat e tjera për shoqërinë e sapokrijuar, gjenden të detajuara në Statutin e shoqërisë bashkangjitur.

Autorizohet Administratori z. Pasquale Cavoto si dhe çdo përfaqësues me prokurë i autorizuar prej tij, për të kryer veprimet e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

### THEMELUES:

Shoqëria "G.P Industry" s.r.l  
Administratori

**G.P. INDUSTRY srl**  
Pasquale Cavoto  
Contrada Montecalvo, 789  
82100 BENEVENTO  
Partita n. 02 839 830 649

Përktheu : Dhimitrulla Vosili 